

Thirrje për Shprehje Interesi për Studentë

Laboratori i debatit mbi integrimin europian në auditorët universitarë
Edicioni 2-Nga Fjala tek Veprimi

Projekti: ‘Laboratori i debatit mbi integrimin europian në auditorët universitarë- Nga Fjala tek Veprimi’

Organizata: Qendra “Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim” (SCiDEV)

Mbështetur nga: Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA)

Afati i shprehjes së interesit: 13 Nëntor 2020

Konteksti

Integrimi europian është prioriteti më strategjik i shtetit Shqiptar dhe rrjedhimisht prek thujtse të gjitha fushat, përfshirë këtu edhe atë të arsimit dhe të të rinjve. Me hapjen e negociatave në pranverën e 2020, Shqipërisë i dalin përpara edhe më shumë sfida. Ndër të tjera, përballimi me sukses i tyre varet edhe nga përgatitja e të rinjve si qytetarë aktiv, të angazhuar, me mendim kritik, aftësi analizuuese, tolerantë dhe etikë në komunikim. Është e rëndësishme edhe përforcimi i një debati publik të shëndetshëm e me bazë të gjerë lidhur me procesin, përfitimet, kostot dhe në tërësi ndikimin që do të ketë integrimi për Shqipërinë si edhe mbi tematika të tjera me interes për zhvillimin social-ekonomik të vendit dhe modelin e zhvillimit në të ardhmen në kushtet edhe të post-krizës COVID19.

Prej tetor 2019 e deri në qershor 2020, me mbështetjen e Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, Qendra ‘Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim’ (SCiDEV) zbatoi me sukses projektin ‘Laboratori i debatit mbi integrimin europian në auditorët universitarë’ në Tiranë dhe Durrës. Përmes këtij projekti u bë e mundur përforcimi i njohurive dhe zhvillimi i analizën kritike të komunitetit të studentëve e kërkuesve të rinj lidhur me Integrimin Europian dhe ndikimin shumëdimensional të tij në Shqipëri përmes organizimit të kampionatit të debatit në auditorët universitarë, fushatave të komunikimit dhe ndërgjegjësimit online, shkrimit të artikujve nga studentë dhe pedagogë në rubrikën [Blog](#), organizimi i takimeve virtuale dhe konferencave me aktorë të tjerë. 108 studentë u angazhuan së bashku me 13 mentorë në 13 universitete publike dhe private.

Gjatë fazës së aplikimeve ka pasur interes dhe numër të konsiderueshëm aplikantësh, jo vetëm nga universitetet e përfshira në këtë fazë të projektit, por dhe nga qytete të tjera universitare të Shqipërisë. Këto zhvillime dëshmojnë interesin e studentëve për temën, angazhimet ekstrakurrikulare dhe nevojën për debat të strukturuar dhe mirë-informuar. Gjatë fazës së zbatimit, gjithashtu pati interes dhe vlerësim për rolin e projektit dhe rëndësinë e vazhdimësisë së tij në të ardhmen.

Pandemia COVID19 paraqiti sfida të mëdha për projektin, por SCiDEV u përqendrua menjëherë në përshtatjen e projektit sipas situatës së re të krijuar ([Video finale](#) me dëshmi nga pjesëmarrësit).

Bazuar në këtë përvojë dhe në interesin e ngjallur nga universitetet, pedagogët dhe studentët, SCiDEV propozon një edicion të dytë të kampionatit. Duke pasur parasysh kontekstin e ri ku veprimi me hapjen e negociatave, me krizën shumë dimensionale social-ekonomike të shkaktuar nga COVID19 si edhe me nevojën për një rini të angazhuar dhe të motivuar, SCiDEV propozon që edicioni i dytë i debatit universitar për integrimin të përshtatet duke përqafuar jo vetëm debatin, por edhe veprimin dhe mbështetjen e të rinjve për aktivizimin e tyre konkret dhe specifik në fushën e arsimit në përditshmërinë e tyre në universitetet dhe më gjerë në jetën publike por edhe sidomos aktivizim online.

Rreth projektit

Qëllimi i projektit është të përforcojë aftësitë dhe mundësitë për veprim në jetën publike të studentëve përmes aktivizimit offline dhe online si edhe zhvillimit të aftësive analizuuese, kritike dhe komunikuese përmes debatit mbi sektorët kryesorë siç është arsimit, por edhe më gjerë, duke kontribuar direkt në përmirësimin e zhvillimit të politikave social-ekonomik për të ardhmen.

Bëhu pjesë!

A dëshiron të zhvillosh më tepër dijet dhe aftësitë rreth proceseve të integritit dhe impaktit në Shqipëri apo më gjerë?

A dëshiron të zhvillosh aftësitë e të menduarit kritik, analizës së thellë, argumenteve të bazuara në evidenca, të folur në publik?

A dëshiron të kontribuosh për një kulturë të rigjallëruar të debatit?

A dëshiron të jesh pjesë e një grupi të rinjsh proaktiv dhe që u dëgjohet zëri?

A dëshiron të jesh aktiv në komunitetin tënd dhe të bësh ndryshimin?

Atëherë, projekti: 'Laboratori i debatit mbi integrimin europian në auditorët universitarë- Nga Fjala tek Veprimi' është për ju!

Studentët e interesuar të shprehin interesin e tyre duke iu drejtuar pedagogëve mentor në 12 universitetet pjesëmarrëse:

1. Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Politike, Universiteti Aleksandër Moisiu, Durrës (FSHJP/UAMD)
2. Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit, Universiteti Bujqësor i Tiranës.
3. Fakulteti i Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës (FSHS/UT)
4. Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës (FE/UT)
5. Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës (FD/UT)
6. Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë, Universiteti i Tiranës (FHF/UT)
7. Instituti i Studimeve Europiane, Universiteti i Tiranës (ISE/UT)
8. Universiteti Europian i Tiranës (UET)
9. Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë (UMSH)
10. Kolegji Universitar Marlin Barleti (MB)
11. Kolegji Universitar Luarasi (Luarasi)
12. Fakulteti i Shkencave Humane, Universiteti Ismail Qemali, Vlorë (UV)

Informacion të mëtejshëm mund të gjeni në rubrikën MENTOR në faqen e projektit: [KËTU](#)

Afati i fundit: 13 nëntor 2020

Ju mirëpresim!